



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:152969

Datë: 23.09.2024

Numri i dokumentit: 06238160

KA.nr.738/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Horn&Co.Kosova” SH.P.K., me NUI 810962739, me seli në fshatin Lebushë - Komuna e Deçanit, përfaqësuar nga avokat Blerim Xheravina nga Prishtina kundër të paditurës Komuna e Pejës e përfaqësuar sipas autorizimit nga Arjeta Veseli avokate, për shkak të anulimit të njoftimit të paditurës për dhënie të kontratës me numër të prokurimit 635-21-1284-2-2-1 të datës 28.06.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 11.09.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit me autorizim të palës paditëse dhe të përfaqësuesit me autorizim të palës së paditur, më datë 23.09.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit “Horn&Co.Kosova” SH.P.K., me seli në fshatin Lebushë, Komuna e Deçanit, kundër të paditurës Komuna e Pejës me seli në Pejë me çka ka kërkuar të anulohet njoftimi i të paditurës për dhënie të kontratës me numër të prokurimit 635-21-1284-2-2-1 i datës 28.06.2021, me propozim që të anulohet kontrata në mes të Komunës së Pejës si dhe Operatorit Ekonomik të shpërblyer me kontratë dhe t’i kompozohet dëmi i shkaktuar në vlerën që do të përcaktohet me ekspertizë me kamat ligjore prej 8% prej datës së parashtrimit të padisë, si e pabazuar.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 13.07.2021, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, paditësi Horn&Co.Kosova” SH.P.K., me seli në fshatin Lebushtë Komuna e Deçanit ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.1559/2021, kundër të paditurës Komuna e Deçanit, për shkak të anulimit të njoftimit për dhënien e kontratës të datës 28.06.2021 me numër të prokurimit me nr. 635-21-1284-2-2-1, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e ushtruar nga këtu paditësi, të anulohet si i kundërligjshëm njoftimi për dhënien e kontratës të datës 28.06.2021 e numër të prokurimit me nr. 635-21-1284-2-2-1, me propozim që të anulohet kontrata në mes të Komunës së Pejës si dhe operatorit ekonomik të shpërblyer me kontratë dhe t’i kompozohet dëmi i shkaktuar në vlerën që do të përcaktohet me ekspertizë me kamat ligjore prej 8% prej datës së parashtrimit të padisë.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA nr. 738/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor më datë 23.08.2024 pastaj më datë 11.09.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse avokat Blerim Xheravina sipas autorizimit të datës 10.07.2021 dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur avokate Arjeta Veseli sipas autorizimit të datës 02.04.2024.

Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se njoftimi i të paditurës si Autoritet Kontraktues (tutje referuar AK) për dhënie të kontratës i datës 28.06.2021 me numër të prokurimit 635-21-1284-2—2-1 si dhe kontrata e lidhur në mes të Komunës së Pejës dhe operatorit ekonomik të shpërblyer me kontratë për këtë aktivitet të prokurimit nuk janë nxjerrë në pajtim me qëllimin e ligjit, por në mënyrë të kundërligjshme, për shkak se janë marr në vërtetimin e gabuar apo jo të plot të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të dispozitave materiale.

5. Ka theksuar se e paditura në veprimet e saj nuk ka aplikuar drejtë dispozitat ligjore, për shkak se pas lejimit të qasjes në dokumente paditësi ka vërtetuar se Operatori Ekonomik (tutje referuar si OE) i shpërblyer me kontratë që është kompania N.T “DONI” i mungojnë certifikata e re e TVSH-së (numri unik), që sipas dosjes së tenderit në nenin 7.1 &7.2 të kërkesa 2 është kërkuar regjistrimi i TVSH-së apo certifikata e TVSH-së, pastaj në kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të kërkuara sipas dosjes së tenderit FTD në nenin 8.1 &8.2 të kërkesa 1 është kërkuar raporti bankar vërtetim apo ndonjë dëshmi tjetër zyrtare financiare që dëshmon qarkullimin financiar për tri vitet e fundit ndërsa operatori Ekonomik i shpërblyer me kontratë ka paraqitur dy dokumente për qarkullim nga e njëjta bankë ku në to shihet qartë se ka mospërputhje të mëdha të qarkullimit bankar. Pastaj lidhur me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të dosjes së tenderit FTD në nenin 9.1 dhe 9.2 të kërkesa 1 është kërkuar nja listë e kontratave të realizuara duke plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerjen e shërbimeve ndërsa OE i shpërblyer me kontratë i mungojnë lista e kontratave të realizuara dhe referencave të kërkuar sipas aneksit 6 (e cila ishte obligative). Te kërkesa 2 e nenit 9.1&9.2 të dosjes së tenderit është kërkuar të paraqitet lista e stafit që do të angazhohet në realizimin e këtij projekti ndërsa OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar listen e stafit të punëtorëve, që do të kyçen dhe angazhohen në realizimin e këtij projekti si dhe kopjen e kontratave të tyre. Po ashtu në të njëjtin nen 9.1 &9.2 të kërkesa 3, është kërkuar lista e mjeteve të punës përkatësisht lista e pajisjeve që OE duhet ti ketë të vetat në pronësi të vet të cilat dëshmohen me kopje të librezave deklarata doganore-fatura apo ndonjë dëshmi tjetër ndërsa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës tek lista e pajisjeve ku është kërkuar që operatori duhet të ketë në pronësi të vetë pajisje motorikë- një ekskavator me goma 16 ton i njëjti ka ofruar një dokument në gjuhën gjermane që konsiderojmë se nuk është librezë as DUD-të dhe as faturë apo dëshmi tjetër që do ta dëshmonte pronësinë mbi atë pajisje ndërsa po ashtu në atë dokument nuk vërehet as tonazhi i kërkuar dhe as lloji i mjetit çfarë është.
6. Sipas tij, pavarësisht të gjitha provave dhe argumenteve të propozuara nga paditësi e paditura me datë 20.04.2021 ka marr vendim me të cilin e kishte refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga paditësi. Paditësi menjëherë me datë 21.04.2021

ka ushtruar ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (tutje OSHP) . Po ashtu edhe raporti i ekspertit të OSHP-së thekson se “bazuar në sqarimet e lart përmendura i njëjti ekspert i ka propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues – paditësi të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim”. Ndërkohë paditësi ju ka drejtuar me shkrim OSHP-së edhe pse pjesërisht ishte në favor raporti i ekspertit i njëjti në disa pika të tij nuk është pajtuar me të dhe duke i par shkeljet e të paditurës, paditësi përmes email-it i propozon OSHP-së që ta ndërpresë këtë aktivitet të prokurimit deri në marrjen e vendimit nga OSHP, mirëpo OSHP me datë 05.07.2021 përmes përgjigjes me shkrim (email) drejtuar paditësit ka theksuar se OSHP nga data 30.03.2021 është pa kryetar dhe pa asnjë anëtar të bordit duke theksuar *“i njoftojmë të gjitha palët në procedurë se në mungesë të bordit është e pa mundur vendim marrja për çfarë do rasti, përjashtimisht në rastet e lejuara sipas rregullores së punës së OSHP”*. E paditura edhe për kundër njoftimi të OSHP-së si dhe duke qenë në dijeni që në bazë të dispozitave ligjore derisa të merr vendim OSHP lidhur me ankesën e ushtruar këtu paditësi duhet të mbetet i pezulluar aktiviteti i prokurimit, ajo nuk e ka ndërprerë aktivitetin e prokurimit por ka vazhduar me njoftimin për dhënie të kontratës OE –së tjetër, ndërsa efektin pezullues të ankesave në mënyrë decitive e ka precizuar dispozita e nenit 112 të LPP-së, e paditura gjithashtu ka bërë shkelje të nenit 54.9 të udhëzuesit operativ të prokurimit publik ku precizohet se *“ushtrimi i ankesës automatikisht e pezullon procedurën e prokurimit”* dhe se është bërë shkelje e nenit 3.1 të rregullave për tenderët jo normalisht të ulët.

7. Kështu që mbi bazën e të gjitha këtyre e paditura me veprimet dhe vendimet e saj kundërligjore ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së të precizuara si në kërkesë padi si dhe rregullave të përcaktuara FTD e po ashtu ka bërë shkeljen e UOPP dhe rregullave për tenderët jo normalisht të ulët, për shkak se paditësi ishte OE më i përgjegjshëm në këtë tender ndërsa ky eliminim i kundërligjshëm për kompaninë e paditësit ka rezultuar me pasoja financiare pasi që i njëjti kishte bërë të gjitha përgatitjet e duhura duke angazhuar staf profesional, pajisje dhe makineri të nevojshme. I ka propozuar gjykatës të aprovoj në tërësi të bazuar kërkesëpadinë e ushtruar nga këtu paditësi, të anulohen si të kundërligjshëm Anulim i Njoftimit për dhënien e kontratës të datës 28.06.2021 e numër të prokurimit me nr. 635-21-1284-2-2-1 me propozim që të anulohet kontrata në mes të Komunës së Pejës si operator ekonomik të shpërblyer me kontratë si dhe t’i kompozohet dëmi i shkaktuar në vlerën që do të përcaktohet me ekspertizë me kamat ligjore prej 8% prej datës së parashtrimit të padisë.

Kundërshtimet e të paditurës

8. Përfaqësuesi i të paditurës në pretendimet e dhëna në përgjigje në padi sipas parashtresës së datës 07.05.2024 ka deklaruar se pretendimet e paditësit janë krejtësisht të pa bazuara në fakte dhe në prova për faktin se e paditura Komuna e Pejës i ka respektuar të gjitha procedurat dhe afatet ligjore të parapara me Ligjin e Prokurimit Publik, me rastin e shpalljes së fituesit dhe dhënies së kontratës. Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës më datë 14.04.2021 ka shpallur njoftimin për dhënien e kontratës duke e shpërblyer me kontrate N.T. “Doni” si ofertues me çmimin më të lirë i cili i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara në tender, ndërsa paditësi si i pakënaqur parashtron kërkesën për rishqyrtim më datë 16.04.2021, ndërsa e paditura më datë 19.04.2021 merr vendim mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit, ndërsa pas shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim të Operatorit ekonomik tani në cilësinë e paditësit autoriteti kontraktues më datë 21.04.2021 kërkesën për rishqyrtim e hedh poshtë si të pa bazuar, ndërsa paditësi ndaj këtij vendimi mbi hedhjen e kërkesës për rishqyrtim më datë 21.04.2021 paraqet ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).
9. Ka shtuar se OSHP më datë 07.05.2021 ka nxjerr raportin e ekspertit shqyrtues, ndërsa paditësi më datë 07.05.2021 lëndën ankuese e dërgon te Paneli Shqyrtues i Prokurimit. Mirëpo OSHP në mungesë të përbërjes së bordit të panelit shqyrtues duke i kaluar të gjitha afatet kohore të përcaktuara me LPP, nuk nxjerr asnjëherë përgjigje përfundimtare në rastin konkret, andaj e paditura në këto rrethana duke vepruar në përputhje me nenin 117 pika 1 të LPP-së e paditura Komuna e Pejës ka dal me njoftim për dhënie të kontratës ndaj OE N.P “Doni” pas 53 ditë pritje për të dal me përgjigje të panelit shqyrtues të OSHP-së, çka do të thotë se një njoftim të tillë e ka ndërmarr në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore të LPP-së.
10. Përfundimisht ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e paditësit se dosjes së këtij tenderi i ka munguar një certifikatë e tvsh-së, raporti i qarkullimit bankar, lista e kontratave të realizuar, lista e stafit të punëtorëve si dhe pajisja e ekskavatorit me goma minimum 16 ton nuk qëndrojnë pasi që një pretendim të tillë e hedh poshtë edhe raporti i ekspertit shqyrtues i OSHP-së i datës 07.05.2021. Lidhur me vetë vlerësimin e paditësit se kinse i ka plotësuar të gjitha kushtet e kërkuar me njoftimin për dhënien e kontratës

nuk qëndron kur dihet se kushti elementar për të dal fitues është çmimi më i lirë i ofruar e që në këtë rast paditësi renditet me çmimin më të lart të ofruar e i cili është 15.850,00 euro më shumë se fituesi i tenderit, andaj me çfarë baze pretendon se do të kishte dal fitues në këtë tender. Lidhur me pretendimin se i është shkaktuar dëm dhe se paditësi ka investuar makineri punëtor e të tjera me çfarë prove e argumenton këtë pretendim, kanë konsideruar se paditësit nuk i është shkaktuar asnjë dëm, as fitimi i humbur pasi që palët nuk janë futur në asnjë raport kontraktual ku do të mund të rrjedhin të drejta dhe detyrime sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-së) dhe se me kohë është njoftuar si tenderuese e pasuksesshme. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit.

Provat e administruara

11. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Njoftimi për dhënie të kontratës me datë 28.06.2021 për aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi i objekteve në Komunën e Pejës”; Njoftimi për kontratë me datë 15.03.2021; Procesverbali i hapjes së tenderit me datë 06.04.2021; Letër standarde për tenderuesin e pa suksesshëm drejtuar OE paditësit; Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues me datë 14.04.2021 me të cilin autoriteti kontraktues Komuna e Pejës e shpërblen me kontratë OE “Doni”; Kërkesë për qasje në dokumente zyrtare nga paditësi drejtuar autoritetit kontraktues me datë 14.04.2021; Kërkesë për rishqyrtim nga paditësi për aktivitetin e prokurimit e parashtruar tek autoriteti kontraktues Komuna e Pejës me datë 16.04.2021; Vendim i autoritetit kontraktues me datë 19.04.2021 mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit; Vendim i autoritetit kontraktues, Njësia e Prokurimit me datë 20.04.2021 me të cilin refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE paditësit “Horn & Co Kosova” dhe vërtetohet vendimi i AK- Njoftimi i publikuar me datë 14.04.2021; Ankesë e paditësit ndaj vendimit të AK e parashtruar tek OSHP me datë 21.04.2021; Raport i ekspertit shqyrtues të OSHP-së H.M. me datë 07.05.2021; Kundërshtim i paditësit në konstatimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së H.M. të datës 07.05.2021; Njoftim i OSHP-së drejtuar paditësit me datë 05.06.2021 me të cilën OSHP sqaron se paneli shqyrtues i OSHP-së është jo funksional pa kryetar dhe pa anëtar të bordit; Dokumenti në gjuhën gjermane të përkthyer në gjuhën shqipe “Ekspertizë për veturën ose automjetin Makinë e punës dhe drejtuese Eskavator DA4 me numër 1612”.

12. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, deklaratimet e përfaqësuesit të paditësit në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpapia e paditësit është e pa bazuar. Nga provat e administruara vërtetohet këtë gjendje faktike:
13. Nga njoftimi për kontratë më datë 15.03.2021, Autoriteti Kontraktues ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi i objekteve në Komunën e Pejës”, me numër të prokurimit 635-21-1284-2-2-1, lloji i kontratës në kategorinë e shërbimeve. Te kërkesat e përshtatshmërisë profesionale te kërkesa 1 është kërkuar certifikata e regjistrimit, ndërsa te kërkesa dy është kërkuar regjistrimi i TVSH-së ku si dëshmi e kërkuar dokumentare ishte kërkuar certifikata e TVSH-së, te kërkesa e kapacitetit ekonomik dhe financiar është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se qarkullimi vjetor i OE-së gjatë tri viteve të fundit financiare duhet të jetë jo më pak se 140,000.00 euro - dëshmia e kërkuar dokumentare - raporti bankar si vërtetim apo dëshmi tjetër zyrtarë financiar e që dëshmon qarkullimin financiar për tri vitet e fundit. Lidhur me kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional te kërkesa 1 është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projektet e ngjashme në vlerë prej 100,000.00 euro në tri vitet e shkuara duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Ndërsa te dëshmia e kërkuar është e kërkuar një listë e kontratave të realizuara duke plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës shumën e kontratës, datën përfundimit dhe përfituesin si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerjen e shërbimeve. Tek kërkesa 2 është kërkuar që të paraqitet stafi që do të angazhohet në këtë projekt të cilët drejtpërdrejt janë përgjegjës në ekzekutimin e punëve, si dëshmi është kërkuar lista e stafit që do të kyqet në realizimin e këtij projekti. Te kërkesa 3 është kërkuar lista e mjeteve të punës si 1. Kamion minimum 10m³, minimum 1 copë 2. Eskavator me goma minimum 16 ton, 1 cop, 3.kamion minimum 1 copë , 4. Kompresor minimum 2 copë, 5.Hilt minimum 2 copë, ku si dëshmi lista e pajisjeve të mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat, në pronësi të vet, të dëshmohe me kopje të librezave deklarate doganore fatura apo ndonjë dëshmi tjetër, të dëshmohe se pajisjet motorike janë të regjistruara dhe kanë sigurim valid. Kriteri i dhënies së kontratës është përcaktuar çmimi më i ulët.

14. Nga Procesverbali i hapjes së ofertave per aktivitetin me titull “Rrënimi i objekteve në Komunën e Pejës”, numri i prokurimit 635-21-1284-2-2-1, datat e hapjes së tenderit 06.04.2021, numri i ofertave të pranuar është 4 në mesin e të cilëve Operatori Ekonomik tani paditës Horn &Co Kosova ShP.K, me çmim të ofertuar për pjesëmarrje në tender në shumë prej 40.847.46 euro, me TVSH 48,2000.00 euro, ndërsa Operatori Ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës N.T. “Doni”, me çmim të ofertuar për pjesëmarrje në tender në shumë prej 27,475.25 euro me TVSh prej 32,350.00 euro.
15. Sipas Njoftimi për dhënie të kontratës me datë 28.06.2021 për aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi i objekteve në Komunën e Pejës”, numri i prokurimit 635-21-1284-2-2-1, Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës në seksionin IV të dhënia e kontratës është specifikuar se kontrata i është dhënë Operatorit Ekonomik N.T. “Doni” , në vlerë të përgjithshme të kontratës prej 32,350.00 euro. autoriteti kontraktues Komuna e Pejës me vendimin me datë 14.04.2021, ka njoftuar se e shpërblen me kontratë OE N.T “Doni” me një çmim të ofertës prej 32,350.00 euro.
16. OE tani paditës është njoftuar nga AK Komuna e Pejës se tenderi i tyre nuk ka qenë i suksesshëm ngase nuk ka qenë tender me çmim më të ulët. Paditësi më datë 16.04.2021 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim nga AK Komunës së Pejës ka kërkuar të bëjë rishqyrtimin e njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues për shpërblim për kontratë.
17. Autoritetit kontraktues me datë 19.04.2021 e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi i objekteve në Komunën e Pejës, me numër të prokurimit 635/21/017/221. Me datë 20.04.2021 Njësia e Prokurimit e ka refuzuar kërkesa për rishqyrtim të OE tani paditësit “Horn &Co Kosova” dhe ka vërtetuar vendimi i AK- Njoftimi i publikuar me datë 14.04.2021.
18. Paditës me datë ka parashtruar ankesë kundër autoritetit kontraktues Komunës së Pejës ndaj aktivitetit të prokurimit me nr. 635-21-1284-2-2-1, sa i përket tenderit me titull “Rrënimi i objekteve në Komunën e Pejës”.
19. Eksperti shqyrtues i OSHP-së H.M. në raport të datës 07.05.2021 ka konstatuar se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës tek dëshmi dokumentare ka bashkangjitur kopjen e

Certifikatës se TVSH-së. Sa i përket dëshmisë se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre (3) viteve të fundit duhet të jetë jo më pak se 140.000.00 euro, eksperti shqyrtues ka konstatuar se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës e ka ofruar deklaratën nga NBL Bank si dëshmi se qarkullimi vjetor nga viti 2017 deri në vitin 2021 në total 170,590.13 euro. Tek dëshmia se ka përfunduar me sukses kontratat për projektet e ngjashme në vlerë prej 100,000.00 euro në (3) tre vitet e shkuara duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues ka konstatuar se në dosjen e tenderit janë ofruar referencat që plotësojnë kërkesën në vlerë prej 100,00.00 euro. Eksperti shqyrtues ka konstatuar se në dosjen e tenderit janë ofruar listat e stafit dhe nuk është kërkuar ndonjë kontratë si dëshmi, pasi që kërkesë e dosjes së tenderit konkretisht tek dëshmi dokumentare është kërkuar lista e stafit që do të kyqet në realizimin e këtij projekti. Eksperti shqyrtues sqaron se te dëshmitë dokumentare është kërkuar lista e pajisjeve-mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat në pronësi të vet të dëshmohen me kopje të librezave deklaratave doganore fatura apo ndonjë dëshmi tjetër, ndërsa eksperti ka sqaruar se në dosjen e tenderit është ofruar një dokument në gjuhën gjermane i cili nuk shihet mirë, ndërsa i ka propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

20. Paditësi e ka kundërshtuar konstatimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së H.M. të datës 07.05.2021 me pretendimin se mendimi i ekspertit është i mangët, i njëanshëm duke bërë favorizime.
21. OSHP-së me datë 05.06.2021, e ka njoftuar paditësin se më datë 30.03.2021 Bordi i OSHP-së ka mbushur 5 vjet nga emërimi i tyre nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ka sqaruar se paneli shqyrtues i OSHP-së nga data 31.03.2021 është jo funksional pa kryetar dhe pa anëtar të bordit, deri sa qeveria dhe kuvendi të emërojnë kryetarin dhe anëtarët e ri të Bordit të OSHP-së.
22. Përfaqësuesja e të paditurës në seancë e ka dorëzuar dokumentit në gjuhën gjermane të përkthyer në gjuhën shqipe “Ekspertizë për veturën ose automjetin Makinë e punës dhe drejtuese, lloji i së cilës është Eskavator DA4 me numër 1612”, lloji i modelit A900 Litronic, pesha e ngarkuar 16000 KG.

Vlerësimi i gjykatës

23. Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e njoftimit të goditur me padi në kuptim të nenit 99 par. 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenin 56 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, i cili përcakton se: 3. *Të gjitha vendimet e nxjerra nga OSHP mund të shqyrtohen nga Gjykata kompetente në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative* si dhe në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative cili përcakton: “Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.
24. Duke marrë parasysh njoftimin e OSHP-së me datë 05.06.2021, me të cilin e ka njoftuar paditësin se nuk ishte e mundur të shqyrtohet ankesa e parashtruar kundër vendimit të autoritetit kontraktues me arsyetimi se paneli shqyrtues i OSHP-së nga data 31.03.2021 është jo funksional pa kryetar dhe pa anëtar të bordit, deri sa qeveria dhe kuvendi të emërojnë kryetarin dhe anëtarët e ri të Bordit të OSHP-së, gjykata shqyrtoj kërkesë padinë e paditësit për anulim të njoftimit të paditurës për dhënie të kontratës me numër të prokurimit 635-21-1284-2-2-1 i datës 28.06.2021, në kuptim të Neni 124 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, paragrafi 6 Shterimi i mjetit juridik administrativ të rregullt, përkatës, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Përrjashtimisht, mund të ngrihet drejtpërdrejt padi në gjykatë, pa qenë e nevojshme shterimi i mjeteve juridike administrative, në këto raste: 6.1. nuk ekziston organi epror. Prandaj gjykata konstatoj se paditësi para ngritje së padisë në gjykatë i ka shterur mjetet juridike administrative ne dispozicion mirëpo nuk ekzistonte organi mbikqyrës për të marrë vendim në ankesën e paditësit pranë OSHP-së, prandaj shqyrtoj ligjshmërinë e aktit të kundërshtuar ne padi dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.
25. Gjykata vlerëson se të gjitha pretendimet e paditësit të ngritura ne padi janë të pabazuara, po ashtu pretendimi se ekspertiza e Ekspertit shqyrtues të OSHP-së H.M. në raport të datës 07.05.2021 është e mangët dhe e pabazuar është e pabazuar në ndonjë provë. Fillimisht gjykata ka vërtetuar se paditësi në padi e ka bashkangjitur vetëm faqen e fundit të ekspertizës, ku eksperti i referohet dëshmisë dokumentare të kërkuar lista e pajisjeve-

mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat në pronësi të vet të dëshmohen me kopje të librezave deklarative doganore fatura apo ndonjë dëshmi tjetër, ndërsa ka sqaruar se në dosjen e tenderit është ofruar një dokument në gjuhën gjermane i cili nuk shihet mirë, për çka i ka propozuar panelit shqyrtues lënda të kthehet në rivlerësim për ta shqyrtuar këtë dokument. Përderisa Gjykata vërteton se të gjitha pretendimet e ngritura me ankesë nga paditësi të shqyrtuara në ekspertizën e prokurimit (te dorëzuar ne gjykate nga e paditura) janë vlerësuar si të pabazuara dhe ishte mbështetur në prova materiale te inkorporuara ne ekspertizë.

26. Gjykata vlerëson se për secilin konstatim të dhënë eksperti i ka bashkangjitur provat materiale: se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës tek dëshmi dokumentare ka bashkangjitur kopjen e Certifikatës së TVSH-së – eksperti i ka bashkangjitur Certifikatën e TVSH-së të OE fitues N.T. Doni me nr. serik 3014780. Sa i përket dëshmisë se qarkullimi vjetor i OE gjatë tre (3) viteve të fundit duhet të jetë jo më pak se 140.000.00 euro, eksperti shqyrtues ka bashkangjitur deklaratën nga NBL Bank si dëshmi se qarkullimi vjetor nga viti 2017 deri në vitin 2021 në total 170,590.13 euro të datës 04.05.2020 dhe vërtetimin mbi gjendjen e llogarisë te NLB bankës me date 29.03.2021. Tek dëshmia se ka përfunduar me sukses kontratat për projektet e ngjashme në vlerë prej 100,000.00 euro në (3) tre vitet e shkuara duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, eksperti shqyrtues ka konstatuar se në dosjen e tenderit janë ofruar referencat që plotësojnë kërkesën në vlerë prej 100,00.00 euro, eksperti shqyrtues i ka bashkangjitur referencën nga Komuna e Pejës te datës 14.05.2020 ne vlere prej 150.930,00 €, referencën nga Komuna e Pejës e datës në vlerë prej 46.454,00 €. Eksperti shqyrtues ka konstatuar se në dosjen e tenderit janë ofruar listat e stafit dhe nuk është kërkuar ndonjë kontratë si dëshmi, pasi që kërkesë e dosjes së tenderit konkretisht tek dëshmi dokumentare është kërkuar lista e stafit që do të kyqet në realizimin e këtij projekti, raportit i a bashkangjitur listën e punëtoreve per vitin 2019, 2020, 2021. Gjykata vlerëson se vërejtja në raportin e eksperti është bërë vetën në raport me dëshmitë dokumentare është kërkuar lista e pajisjeve-mjeteve të punës që OE duhet ti ketë të vetat në pronësi të vet të dëshmohen me kopje të librezave deklarative doganore fatura apo ndonjë dëshmi tjetër, me vërejtje se në dosjen e tenderit është ofruar një dokument në gjuhën gjermane i cili nuk shihet mirë.

27. Përfaqësuesja e të paditurës në seancë e ka dorëzuar dokumentit në gjuhën gjermane të përkthyer në gjuhën shqipe “Ekspertizë për veturën ose automjetin Makinë e punës dhe drejtuese, lloji i së cilës është Eskavator DA4 me numër 1612”, lloji i modelit A900 Litronic, pesha e ngarkuar 16000 KG, nga e cila gjykata ka vërtetuar se OE fitues kishte ofruar dëshminë sipas kërkesës së dosjes së tenderit “eskavator me goma minimum (16ton), minimum 1 cope.
28. Prandaj gjykata vlerëson Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës në Njoftimi për dhënie të kontratës me datë 28.06.2021 për aktivitetin e prokurimit me titull “Rrënimi i objekteve në Komunën e Pejës”, numri i prokurimit 635-21-1284-2-2-1, me të cilin i është dhënë kontratat Operatorit Ekonomik N.T. “Doni”, në vlerë të përgjithshme të kontratës prej 32,350.00 euro është në përputhje me Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP), Neni 7 përcakton Barazinë në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1 parasheh se “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, Neni 27 që përcakton Dosjen e Tenderit paragrafi 1 parasheh se *“Përveç siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni autoriteti kontraktues do të përpiloj një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termat dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe 24 informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Neni 52 përcakton njoftimin e kritereve për dhënien e kontratës paragrafi 1 parasheh se “Autoriteti kontraktues në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit do të specifikoj kriteret që do të përdoren për dhënie të kontratës. Kriteret mund të jenë ose çmimi më i ulët ose tenderi ekonomikisht më i favorshëm”.*
29. Sepse Autoriteti Kontraktues Komuna e Pejës njoftimit për kontratë me titull “Rrënimi i objekteve në Komunën e Pejës”, ka shpallur me date 15.03.2021 lloji kontratës kryerja e shërbimeve duke i përcaktuar kushtet e pjesëmarrjes për të gjithë operatorët ekonomik në përputhje me Ligjin përkatës të Prokurimit Publik, me numër nr. 04/l-042. Përmes procesverbalit të hapjes së tenderit nga autoriteti kontraktues ka konstatuar se kane ofertuar katër (4) operatorë ekonomik me ofertat e tyre, në mesin e të cilëve rezulton edhe paditësi Horn &Co.Kosova SH.P.K, me çmim të ofertës prej 48,200.00 euro me TVSh

dhe operatori ekonomik N.T. “Doni” me çmim të ofertës prej 32,350.00 euro me TVSh, në përputhje me Nenin 60 përcakton Kriteret për Dhënien e Kontratës, paragrafi 1 përcakton se *“Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar”, 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët; 1.2 tenderin ekonomikisht më të favorshëm në bazë të kriterëve dhe peshën që është specifikuar në dosjen e tenderit sipas nenit paragrafit 3. të nenit 52 të këtij ligji”*.

30. Gjykata vlerëson se AK ka vepruar në Neni 112 të LPP-së ka pezulluar zbatimin e aktivitetit të prokurimit pas ankesës së paditësit dhe me rastin e vazhdimi të aktivitetit ka vepruar në pajtim me nenin Neni 117 ku përcaktohet afati i fundit për marrjen e vendimeve *par.1 parasheh se "OSHP do të nxjerrë vendimin e tij përfundimtar me shkrim, së bashku me një deklaratë me shkrim mbi arsyet faktike dhe ligjore mbi të cilat është marrë një vendim i tillë, dhe ndonjë urdhër që nevojitet për zbatimin e vendimit të tillë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas skadimit të afatit kohor të specifikuar në paragrafin 7. të nenit 115 të këtij ligji, apo pas dorëzimit të informative shtesë dhe/apo shpjegimeve apo dëgjimeve sipas nenit paragrafin 3. apo 4. të nenit 116 të këtij ligji. Kur në çështje janë të përfshira fakte veçanërisht të ndërlikuara, OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrin të tij”, në rastin në fjalë kishin kaluar të gjitha afatet për marrjen e një vendimi nga OSHP.*
31. Kërkesa e paditësit për kompensim të fitimit të humbur për mos dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, është e pabazuar në kuptim të nenit 46. paragrafi 4 të LKA-së ku përcaktohet *se kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative, sepse në këtë rast nuk u anulua akti administrativ i kundërshtuar.*
32. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi për shpenzime procedurale shpenzimet procedurale u more në bazë të nenit 64 të LKA-së

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.738/22, datë 23.09.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.